



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**FOL**



# **Raport:** Gjetjet e anketës mbi të kuptuarit dhe perceptimin e sinjalizimit nga punonjësit e sektorit privat

Prill, 2024



**Raport: Gjetjet e  
anketës mbi të kuptuarit  
dhe perceptimin e  
sinjalizimit nga punonjësit  
e sektorit privat**

TITLE

**Raport: Gjetjet e anketës mbi të kuptuarit dhe perceptimin e sinjalizimit nga punonjësit e sektorit privat**

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

PRILL, 2024

WEBSITE:

[www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

**Të drejtat e autorit © 2024. Lëvizja FOL.** Të drejtat e autorit © 2023. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

**Mohim përgjegjësie:** Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë dokument nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

# Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive	6
1. Hyrja	9
2. Metodologjia	10
3. Rezultatet e anketave	13
4. Intervista me Inspektoratin e Punës	24
5. Intervista me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit	25
6. Shënime përmbyllëse	27
Shtojca I – Pyetëtori	28

## Lista e shkurtesave

<b>LMS</b>	Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve
<b>IP</b>	Inspektorati i Punës
<b>APK</b>	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>ARBK</b>	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës

# Përmbledhja ekzekutive

Sinjalizimi brenda sektorit privat është i rëndësishëm për identifikimin, parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe shkeljeve të tjera etike. Ai nxit kulturat organizative duke theksuar përgjegjshmërinë dhe integritetin, ndërsa ofron njohuri të vlefshme për përmirësimet e procesit dhe inovacionin. Krijimi i strukturave të qarta raportuese dhe sigurimi i ndërgjegjësimit të punonjësve për këto mekanizma janë thelbësore për zbatimin e ligjit. Lëvizja FOL, me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, ka zhvilluar anketa me përfaqësues të bizneseve në gjithë territorin e Kosovës që kanë mbi 50 të punësuar, për të vlerësuar se sa janë të informuar subjektet e sektorit privat për mekanizmin e sinjalizimit dhe nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat.

Të dhënat primare janë marrë përmes një ankete online të kryer me bizneset e identifikuara përmes Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe informacioneve të ofruara nga Administrata Tatimore e Kosovës..

Për më tepër, për qëllim të këtij raporti, Lëvizja FOL ka zhvilluar intervista edhe me Inspektoratin e Punës (IP) dhe me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), si institucione përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtij ligji, në lidhje me sfidat e këtyre institucioneve në kryerjen e obligimeve ligjore.

## Gjetjet kryesore

- Ndërmjet analizës së të dhënave të mbledhura, ka dalë në pah se një pjesë e bizneseve janë të informuara për ekzistimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), dhe pjesa më e madhe e tyre janë të vetëdijshëm se duhet të caktojnë zyrtarë përgjegjës për sinjalizim. Tutje, shumica kanë raportuar se nuk kanë pasur vështirësi në kuptimin e konceptit të sinjalizimit. Megjithatë, krahas kësaj, pjesa më e madhe e bizneseve të anketuara, apo 75% janë shprehur se nuk kanë krijuar akte të brendshme për të rregulluar procedurën e pranimit dhe trajtimit të rasteve të sinjalizimit brenda subjektit privat, obligim që e parasheh LMS-ja.
- Shumica e bizneseve të anketuara shprehën sfida për të kuptuar procedurat e sinjalizimit. Konkretisht, 50% e të anketuarve kanë raportuar se i kanë parë hapat/procedurat si "shumë të vështira", ndërsa 25% kanë treguar se i kanë parë si "pak të vështira". Nga ana tjetër, 25% e bizneseve i perceptonin procedurat si "mjaft të lehta".
- Për sa i përket rëndësisë së mekanizmit të sinjalizimit, 50% e bizneseve e vlerësuan atë si "shumë të rëndësishëm" për raportimin brenda mjedisit të punës. Në të kundërt, 38% e të anketuarve e konsideruan atë si "pak të rëndësishme", ndërsa 12% e konsideruan si "aspak të rëndësishme".

- Një shumicë e konsiderueshme (88%) e bizneseve të anketuara identifikuan nevojën për trajnim për të kuptuar procedurat e sinjalizimit. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk kishte organizuar sesione të tilla trajnimi, gjë që tregon një boshllëk në përgatitje.
- Shumica e bizneseve nuk raportuan histori raportimi tek organet kompetente, me vetëm 60% që shprehën gatishmërinë për ta bërë këtë nëse është e nevojshme. Kjo sugjeron një mungesë të mundshme ndërgjegjësimit ose besimi në përdorimin e mekanizmave të sinjalizimit.
- Shumica (75%) e bizneseve të anketuara e pranuan rëndësinë e zbatimit të mekanizmave të sinjalizimit në Kosovë, duke reflektuar një konsensus mbi domosdoshmërinë e masave të tilla për promovimin e transparencës dhe llogaridhënies.
- Vetëm një pjesë e vogël (20%) e bizneseve të anketuara i janë nënshtruar inspektimit nga Inspektorati i Punës në lidhje me emërimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizimin. Kjo nxjerr në pah nivelet e pamjaftueshme të mbikëqyrjes në sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloret përkatëse.
- Inspektorati i Punës njohu mangësitë në mbikëqyrje, duke i atribuar ato me kufizime logjistike. Kjo tregon sfida në mbikëqyrjen efektive të zbatimit të protokolleve të sinjalizimit.
- As IP-ja dhe as APK-ja nuk kanë kryer trajnime të synuara për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke theksuar nevojën e mundshme për përpjekje për ngritjen e kapaciteteve. Agjencia planifikon të trajnojë zyrtarë sinjalizues nga institucionet publike në vitin 2024 për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për kornizat e sinjalizimit dhe për të eksploruar rrugët për krijimin e kanaleve të tilla në sektorin privat.

## Bazuar në rezultatet e anketës, ofrohen rekomandimet e mëposhtme:

- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese që synojnë entitetet e sektorit privat për t'i edukuar ato në lidhje me detyrimet e tyre sipas LMS-së dhe avantazhet e zbatimit të mekanizmave të sinjalizimit.
- Inkurajimi i subjekteve të sektorit privat që të emërojnë zyrtarë të caktuar për sinjalizim dhe të vendosë procedura të brendshme për trajtimin e rasteve të sinjalizimit për të siguruar raportim efektiv dhe mbrojtje të sinjalizuesve.
- Krijimi i kanale të sigurta raportimi brenda bizneseve duke emëruar zyrtarë të caktuar përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.
- Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit për t'i njohur ata me procedurat e sinjalizimit dhe për të theksuar rëndësinë e tyre. Rritja e ndërgjegjësimit mund të çojë në rritjen e raportimit të parregullsive dhe të nxisë një kulturë transparence brenda organizatave.

- Zhvillimi i protokoleve të brendshme brenda subjekteve private për të drejtuar në mënyrë efektive trajtimin e rasteve të sinjalizimit.
- Rritja e fuqisë punëtore të IP-së për të siguruar mbikëqyrje efektive të zbatimit të LMS-së në sektorin privat. Kjo përfshin nisjen e veprimeve kundër subjekteve që dështojnë të respektojnë kërkesat e ligjit.
- Rritja e stafit profesional të IP-së për të rritur mbikëqyrjen dhe zbatimin e LMS-së brenda sektorit privat.
- Avokimi që Qeveria e Kosovës, veçanërisht Ministria e Drejtësisë, të bëjë një vlerësim ex-post të LMS-së. Ky vlerësim duhet të vlerësojë efikasitetin e tij dhe të eksplorojë rrugët për ndryshime për të specifikuar autoritetet kompetente përgjegjëse për marrjen dhe hetimin e raporteve nga subjektet e sektorit privat, duke siguruar kështu zbatimin e duhur të ligjit.



# 1. Hyrja

Ky raport i përshkruan gjetjet nga anketa e realizuar nga Lëvizja FOL dhe e përkrahur nga Aktiviteti i USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, e realizuar nga periudha shkurt deri në mars 2024. Qëllimi i anketimit ishte që të vlerësohet niveli i informimit të subjekteve të sektorit privat, kryesisht të të punësuarve në këto biznese, për mekanizmin e sinjalizimit/raportimit të shkeljeve dhe keqpërdorimeve, dhe se sa po zbatohet realisht ky mekanizëm.

Sinjalizimi si mekanizëm për raportim është paraparë në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2018, ndërsa dispozitat për sektorin privat janë fuqizuar një vit më vonë (dhjetor 2019). Ky ligj i detyron të gjithë punëdhënësit publik që kanë më shumë se 15 të punësuar dhe punëdhënësit privat që kanë më shumë se 50 të punësuar të emërojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim.

Ky ligj paraqet një hallkë të rëndësishme të harmonizimit të ligjeve nacionale me politikat dhe qëllimet e Bashkimit Evropian në drejtim të rregullimit juridik të çështjes së sinjalizimit. Me 32 nenet të cilat i ka, LMS-ja përcakton rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Sinjalizimi në sektorin privat, shërben si një mjet kyç për të identifikuar, parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe shkeljet e tjera etike dhe ligjore brenda subjekteve të sektorit privat. Sinjalizimi gjithashtu përmirëson kulturën organizative të subjekteve private, duke nxitur një mjedis ku përgjegjshmëria dhe integriteti janë vlera themelore. Raportimet nga sinjalizimi mund të shërbejnë si burim i vlefshëm i informacionit për përmirësimin e proceseve dhe zhvillimin e inovacioneve brenda organizatave.

Prandaj, krijimi i strukturave të qarta për raportim të shkeljeve, keqpërdorimeve apo sjelljeve jo etike, si dhe sigurimi që të punësuarit të jenë të njoftuar me këto struktura, paraqet një domosdoshmëri për zbatimin e duhur të ligjit. Rrjedhimisht, është i domosdoshëm përkushtimi në qartësimin e dispozitave ligjore për hapat e raportimit dhe qartësimi i institucioneve kompetente për të bërë sinjalizimin në këtë sektor, për të siguruar zbatimin e këtij ligji, si një hap jetik për të ngritur integritetin, transparencën, dhe konkurrencën në treg. Parandalimi i keqpërdorimeve eventuale në sektorin privat ka ndikim shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar të një vendi, andaj fuqizimi dhe ngritja e vetëdijes së punëtorëve të sektorit privat për këtë mekanizëm duhet të shihet si domosdoshmëri.

Ky raport përfshinë përshkrimin e rezultateve të anketave mbi nivelin e zbatimit të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat, dhe nivelin e informimit të të punësuarve të këtij sektori me termin sinjalizim. Gjithashtu, ky raport synon të identifikoj mangësitë praktike në zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga ana e bizneseve, duke synuar nxjerrjen e rekomandimeve për zbatimin efektiv të ligjit dhe shmangien e paqartësive për të punësuarit e sektorit privat në lidhje me hapat e raportimit.

## 2. Metodologjia

Me qëllim të informimit të saktë me nivelin e informimit të përfaqësuesve të kompanive/subjekteve të sektorit privat mbi mekanizmin e sinjalizimit dhe me nivelin zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat, si dhe me perceptimin e këtyre subjekteve për nevojën e zbatimit të këtij mekanizmi në rrethanat e Kosovës, Lëvizja FOL ka realizuar anketa me 55 subjekte/kompani të sektorit privat me mbi 50 të punësuar në tërë territorin e Kosovës.

Fillimisht, të dhënat e subjekteve të sektorit privat me mbi 50 të punësuar janë siguruar nga ATK-ja, përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. Ndërsa kontaktet e këtyre bizneseve janë gjetur përmes kërkimit të tyre në mënyrë manuale në portalin e ARBK-së dhe përmes formave të tjera të mundshme (kërkimi i llogarive të tyre në rrjetet sociale).

Nga të gjitha subjektet e sektorit privat sa operojnë aktualisht, me mënyrën manuale të kërkimit janë gjetur kontaktet (adresat elektronike dhe numrat e telefonit) e 221 bizneseve. Më pas, anketa e zhvilluar e përbërë nga 18 pyetje ([shih SHTOJCA I](#)), e cila i është dërguar listës së kontakteve të bizneseve të identifikuara.

Pjesa më e madhe e të anketuarve të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të parashtruara në anketa ishin nga Rajoni i Prishtinës, përkatësisht 40% e të anketuarve, ndërsa 15% nga Rajoni i Mitrovicës, 7% nga Rajoni i Gjilanit, 4% nga Rajoni i Pejës dhe 2% nga Rajoni i Gjakovës. Gjithashtu, pjesa më e madhe e subjekteve të anketuara ishin nga sektori i ndërtimitarisë, sektori i marketeve, gastronomisë dhe prodhimitarisë.

Për nevojat e këtij raporti, Lëvizja FOL ka intervistuar edhe përfaqësuesit e IP-së dhe të APK-së në lidhje me sfidat dhe nevojat e këtyre institucioneve në mbikëqyrjen e këtij ligji për sektorin privat dhe publik. Intervistat me këto institucione janë zhvilluar me shkrim.

**Pjesa më e madhe e të anketuarve të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të parashtruara në anketë ishin**

Rajoni i Prishtinës 40%


Rajoni i Mitrovicës 15%

Rajoni i Gjilanit 7%

Rajoni i Pejës 4%

Rajoni i Gjakovës 2%

Gjithashtu, pjesa më e madhe e subjekteve të anketuara ishin nga sektori i ndërtimitarisë, sektori i marketeve, gastronomisë dhe prodhimitarisë.



## 3. Rezultatet e anketave


Në tekstin vijues, janë dhënë përgjigjet e përfaqësuesve të bizneseve të anketuara në lidhje me pyetjet e parashtruara në anketë (shih Shtojca I). Rezultatet e anketës janë paraqitur në përqindje për të siguruar qartësi dhe kuptueshmëri për lexuesin.

Prandaj, kjo analizë ofron njohuri mbi perceptimet dhe qëndrimet e subjekteve të sektorit privat në lidhje me mekanizmin e sinjalizimit dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në kontekstin e Kosovës.

## 01 A JENI NË DIJENI PËR EKZISTIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE?

Të dhënat e anketës tregojnë se 53% e bizneseve të anketuara nuk ishin në dijeni për ekzistimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ndërsa 47% raportuan se ishin të vetëdijshëm për ligjin.

Përfaqësuesit e bizneseve që kanë mungesë të njohurive për këtë ligj vijnë nga sektorë të ndryshëm si: markete, sektori i ndërtimit, industria ushqimore dhe call center.




**Figura 1.** Përgjigjet e përfaqësuesve të bizneseve në lidhje me informimin e tyre për ekzistimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Këto gjetje nënvizojnë domosdoshmërinë e iniciativave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të bizneseve lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve brenda komunitetit të biznesit. Masat e propozuara mund të përfshijnë fushata të shpërndarjes së informacionit, sesione trajnimi dhe forcimin e burimeve të dedikuara për mbikëqyrjen e zbatimit të sinjalizimit.

## 02 A E DINI QË SIPAS LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE E KENI OBLIGIM PËR TË CAKTUAR ZYRTARIN PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM NË KOMPANINË TUAJ?

Të dhënat e anketës tregojnë se 64% e bizneseve të anketuara nuk janë të vetëdijshëm për kërkesën ligjore për të caktuar një zyrtar përgjegjës për sinjalizimin. Nga ana tjetër, 36% e bizneseve raportuan se e kishin këtë informacion. Kështu, shumica e bizneseve e kanë pranuar se janë të painformuar për këtë detyrim ligjor.

Kjo gjetje nxjerr në pah mungesën e informacionit të qartë në lidhje me këtë aspekt, duke sugjeruar një mundësi që bizneset të ndërmarrin masa për edukimin e tyre lidhur me detyrimet ligjore. Masa të tilla mund të përfshijnë hartimin e politikave të qarta dhe vendosjen e procedurave për të përmirësuar zbatimin efektiv të dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.




**Figura 2.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me informimin e tyre për obligimin ligjor për të caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim

Ndër 36% e bizneseve të vetëdijshëm për detyrimin ligjor për të caktuar zyrtarë përgjegjës për sinjalizim, 65% (13 biznese) kanë konfirmuar emërimin e zyrtarëve të tillë. Nga ana tjetër, pjesa e mbetur prej 35% e bizneseve deklaruan se nuk kanë emëruar ende zyrtarë përgjegjës për sinjalizimin brenda kompanive të tyre.

Kjo gjetje thekson se një pjesë e konsiderueshme e bizneseve të informuara për detyrimin ligjor për emërimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizimin kanë vepruar sipas këtij detyrimi. Megjithatë, mbetet një segment tjetër që ende nuk ka caktuar një zyrtar për këtë qëllim, pavarësisht se është në dijeni të detyrimit ligjor.

### 03 A KENI PASUR NDONJËHERË JU OSE DIKUSH NGA KOLEGËT TUAJ PROBLEM NË KUPTIMIN E TERMIT "SINJALIZIM"?

Sipas rezultateve të anketës, vetëm 15% e të anketuarve kanë shprehur dyshime për kuptimin e termit "sinjalizues", ndërsa 85% e mbetur kanë deklaruar se nuk kanë hasur kurrë vështirësi në kuptimin e këtij termi. Kjo tregon se shumica e të anketuarve ishin të njohur me konceptin e sinjalizimit. Për këto biznese, termi "sinjalizues" ka të ngjarë të rezonojë me nocionet e integritetit të vendit të punës, mbrojtjes dhe trajtimit të abuzimit.



**Figura 3.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me informimin e tyre për kuptimin e termit "sinjalizim".


Ndër bizneset që raportuan vështirësi për të kuptuar termin sinjalizim, përgjigjja e një të anketuari për këtë pyetje ishte: "Nuk e kam idenë se çka nënkupton sinjalizimi?".

Përgjigjet e tjera përfshinin: "Fjalë shumë e përgjithshme. Pa e lexuar ligjin e pakuptueshme se për çfarë sinjalizimi bëhet fjala. Fjala duhet të jetë më precize"; "Nuk e kemi dëgjuar më parë" dhe "Nuk kemi qenë në njohuri për këtë ligj".

#### 04 A KENI HARTUAR AKT TË BRENDSHËM ME TË CILIN RREGULLOHET PROCEDURA E PRANIMIT DHE TRAJTIMIT TË RASTEVE TË SINJALIZIMIT NË KOMPANINË TUAJ?

Sipas gjetjeve të anketës, 75% e të anketuarve nuk kanë hartuar protokolle të brendshme për menaxhimin e rasteve të sinjalizimit, ndërsa vetëm 25% e kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.


Kjo nxjerr në pah një boshllëk të dukshëm në marrjen e hapave të nevojshëm për hartimin dhe zbatimin e protokolleve të brendshme për të menaxhuar rastet e sinjalizimit brenda vendeve të tyre të punës për shumicën e bizneseve.



**Figura 4.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me hartimin e akteve të brendshme me të cilën rregullohet procedura e pranimin dhe trajtimit të rasteve të sinjalizimit.

## 05 SA E KENI TË VËSHTIRË PËR TË KUPTUAR HAPAT / PROCEDURAT E RAPORTIMIT/SINJALIZIMIT, TË PËRCAKTUAR NË LIGJIN PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE?

Bazuar në rezultatet e anketave, 50% e respondentëve kanë thënë se e kanë shumë të vështirë për të kuptuar hapat/procedurat e raportimit/sinjalizimit të përcaktuara me ligj. Ndërsa 25% e respondentëve kanë thënë se e kanë pak të vështirë për të kuptuar këta hapa/procedura. Ndërsa 25% e respondentëve kanë thënë se nuk e kanë fare të vështirë për të kuptuar procedurat e raportimit.



**Figura 5.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me vështirësitë për të kuptuar hapat procedurat e sinjalizimit.


Bazuar në këto rezultate, të kuptuarit e këtyre hapave dhe procedurave përbën një sfidë për një numër të konsiderueshëm biznesesh. Për të adresuar këtë çështje dhe për të siguruar një kuptim të qartë dhe zbatimin e duhur të këtyre procedurave, është thelbësore t'u ofrohet trajnim dhe udhëzim gjithëpërfshirës këtyre subjekteve. Kjo qasje do të rrisë ndërgjegjësimin dhe do të sigurojë zbatimin korrekt të ligjit, duke nxitur përfundimisht një mjedis pune më të drejtë dhe më të sigurt për të gjithë punonjësit.



## 06 SA TË RËNDËSISHËM E SHIHNI SINJALIZIMIN SI MEKANIZËM PËR RAPORTIM NË AMBIENTIN TUAJ TË PUNËS?

Rezultatet e anketës tregojnë se 50% e të anketuarve e konsiderojnë sinjalizimin si një mekanizëm shumë të rëndësishëm raportimi në vendin e punës. Gjithashtu, 38% e vlerësuan atë si disi të rëndësishëm, ndërsa 12% e bizneseve e vlerësuan këtë mekanizëm si të parëndësishëm.

Ky rezultat pasqyron perceptime të ndryshme në lidhje me rëndësinë e sinjalizimit për raportimin në vendin e punës. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e shohin sinjalizimin si një mjet thelbësor për identifikimin dhe raportimin e çështjeve të rëndësishme në vendin e punës, të tjerët e perceptojnë atë si më pak të rëndësishëm ose aspak të rëndësishëm.



**Figura 6.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me rëndësinë e sinjalizimit.

## 07 A KENI PASUR NDONJËHERË NEVOJË PËR NDONJË TRAJNIM TË VEÇANTË PËR TË KUPTUAR OSE PËR TË PËRDORUR SINJALIZIMIN NË AMBIENTIN TUAJ TË PUNËS?

Sipas gjetjeve të anketës, shumica e të anketuarve (88%) shprehën nevojën për trajnime të specializuara për të kuptuar dhe përdorur sinjalizimin si mekanizëm. Nga ana tjetër, 12% deklaruan se nuk kishin nevojë për ndonjë trajnim të veçantë për të kuptuar dhe përdorur këtë mekanizëm.

Ky rezultat nënvizon një kërkesë të konsiderueshme për trajnime dhe informacion shtesë në lidhje me sinjalizimin në vendin e punës. Për shumicën e të anketuarve, sinjalizimi duket të jetë një fushë komplekse me sfida të ndryshme që kërkojnë njohuri të zgjeruara dhe aftësi të specializuara për ta kuptuar dhe përdorur në mënyrë efektive. Sesionet e specializuara të trajnimit mund të luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive midis bizneseve, duke u mundësuar atyre të identifikojnë, raportojnë dhe adresojnë më mirë rastet e dyshimta në mënyrë efektive.




**Figura 7.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me nevojën për trajnime për të kuptuar ose përdorur sinjalizimin.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu nëse organizatat e tyre kishin mbajtur sesione trajnimi për këtë çështje dhe të gjithë të anketuarit (100%) konfirmuan se ata kurrë nuk kishin organizuar sesione të tilla trajnimi. Ky rezultat sugjeron një mungesë të gjerë të trajnimit të dedikuar në lidhje me sinjalizimin në mjedisin e punës për të gjithë personelin e anketuar.

## 08 A KA PARAQITUR NDONJËRI NGA ANËTARËT E STAFIT TUAJ NDONJË PARREGULLSI TË BRENDSHME TEK UDHËHEQËSIT E KOMPANISË?

Bazuar në rezultatet e anketës, 67% e bizneseve të anketuara janë përgjigjur negativisht në lidhje me përpjekjet e tyre për të adresuar parregullsitë me punëdhënësit e tyre. Nga ana tjetër, 33% e bizneseve pranuan raste kur ata ose kolegët e tyre raportuan parregullsi tek punëdhënësit e tyre.

Ky rezultat nxjerr në pah një ndarje të dallueshme midis bizneseve që u përmbaheshin kërkesave ligjore dhe nxitën një kulturë të hapur të raportimit të parregullsive te punëdhënësi dhe atyre që nuk i respektuan.



**Figura 8.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me atë se a kanë raportuar shkelje/parregullsi tek punëdhënësi.

**09 A KENI PASUR NDONJËHERË NDONJË RAST KU KOMPANIA JUAJ KA PARAQITUR NDONJË PARREGULLSI OSE VEPRIM TË JASHTËLIGJSHËM PARA ORGANEVE KOMPETENTE (p.sh. shmangie të tatimit nga ndonjë kompani që keni pasur bashkëpunim; kallëzim të ndonjë vepre penale etj.)?**


Lidhur me këtë çështje, rezultatet e anketës tregojnë se asnjë nga bizneset e anketuara nuk ka raportuar për ndonjë parregullsi apo veprim të kundërligjshëm tek autoritetet përkatëse. Ky konstatim nënvizon mungesën e rasteve të raportuara për parregullsi apo veprime të kundërligjshme tek organet kompetente nga bizneset e anketuara.



**Figure 9.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me atë se a kanë raportuar shkelje/parregullsi tek organet kompetente.

## 10 A MENDONI SE SINJALIZIMI NË SEKTORIN PRIVAT ËSHTË I NEVOJSHËM PËR RRETHANAT E KOSOVËS?


Sa i përket perceptimit të bizneseve të anketuara lidhur me domosdoshmërinë e zbatimit të këtij mekanizmi në rrethanat e Kosovës, rezultatet e anketës tregojnë se 75% e bizneseve janë përgjigjur pozitivisht për këtë çështje, ndërsa 25% e subjekteve të anketuara e kanë konsideruar të panevojshme. Përçindja e lartë e përgjigjeve pozitive tregon një vetëdije të fortë në mesin e bizneseve lidhur me rëndësinë dhe efektivitetin e këtij mekanizmi në kontekstin e Kosovës. Në këtë drejtim, është thelbësore që autoritetet dhe organizatat përkatëse të vazhdojnë në promovimin dhe mbështetjen e zbatimit të këtij mekanizmi për të nxitur një mjedis pune më të drejtë, më transparent dhe më të sigurt për të gjitha palët e interesuara në Kosovë.



**Figura 10.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me vlerësimin e tyre për nevojën e zbatimit të këtij mekanizmi në rrethanat e Kosovës.

## 11 A JENI TË GATSHËM TË RAPORTONI PËR NDONJË SHKELJE APO MOSFUNKSIONIM QË VËRENI NË AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK OSE NË AKTIVITETET TJERA QË LIDHEN ME INSTITUCIONET PUBLIKE (si p.sh. në shpërndarjen e subvencioneve, licencave, lejeve etj.)?

Sipas gjetjeve të anketës, 60% e bizneseve shprehën gatishmërinë për të raportuar shkelje të mundshme në aktivitetet e lidhura me institucionet publike, ndërsa pjesa tjetër 40% treguan se nuk ishin të përgatitur të raportonin për çështje të tilla. Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve e konsiderojnë të rëndësishme raportimin e shkeljeve të mundshme dhe janë të gatshëm të angazhohen në këtë proces. Megjithatë, një segment tjetër i bizneseve heziton të raportojë shkelje të tilla në institucionet publike. Kjo divergjencë në perceptim mund të rrjedhë nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë mosbesimin në institucionet publike, frikën nga pasojat e mundshme për raportim, ose mungesën e ndërgjegjësimit për procedurat e raportimit.



**Figura 11.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me atë se a janë të gatshëm për të raportuar shkelje/parregullsi tek organet kompetente.

## 12 A JENI INSPEKTUAR APO KONTAKTUAR NDONJËHERË NGA INSPEKTORATI I PUNËS NË LIDHJE ME CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM?

Sipas rezultateve të anketimit, 20% e bizneseve të anketuara i janë nënshtruar inspektimit nga IP-ja lidhur me emërimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizimin, ndërsa shumica prej 80% kanë raportuar se nuk janë inspektuar asnjëherë nga IP-ja për këtë çështje. Kjo sugjeron se vetëm një përqindje e vogël e bizneseve i janë nënshtruar inspektimit në këtë kontekst, ndërkohë që shumica nuk kanë hasur në kontrole të tilla.



**Figura 12.** Përgjigjet e bizneseve në lidhje me atë se a janë inspektuar nga IP në lidhje me caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim.

## 4. Intervista me Inspektoratin e Punës

Për qëllimet e këtij hulumtimi, Lëvizja FOL ka zhvilluar intervista me shkrim edhe me Inspektoratin e Punës, si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji për sektorin privat.<sup>1</sup> Ky institucion aktualisht ka 63 inspektorë të punës, dhe sipas tyre, brenda këtij viti pritet të shtohen edhe 57 të tjerë.

Në këtë kontekst, në lidhje me masat e planifikuara për sigurimin e zbatimit të LMS-së brenda IP-së, nga inspektorati kanë thënë se: *“Inspektorati Qendror i Punës (IQP), ne kuadër të planit të punës është duke ndërmarr veprimet me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve brenda Inspektoratit Qendror të Punës duke caktuar zyrtarin përgjegjës në kuadër të IQP-së i cili ka njoftuar stafin inspektues me obligimet ligjore tek subjektet të cilat kanë mbi 50 të punësuar”.*

Në përgjigje të asaj se a e perceptojnë veten si institucion kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, Inspektorati i Punës deklaroi se me shtimin e burimeve njerëzore do të pajisen më mirë për të siguruar mbikëqyrje efektive të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS) në sektorin privat. Gjithashtu, inspektorati ka raportuar se ka kryer inspektime në këtë fushë dhe mban raporte mujore për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, me fokus primar sinjalizimin. Sipas të dhënave të tyre për periudhën janar-shkurt 2024, IP-ja dokumentoi se 7 biznese kishin caktuar zyrtarë përgjegjës për sinjalizimin. Ata identifikojnë mungesën e mbështetjes logjistike si pengesë kryesore në mbikëqyrjen efektive të LMS-së. Sa i përket trajnimeve për mbikëqyrjen e zbatimit të LMS-së, inspektorati deklaroi se asnjëherë nuk kanë mbajtur sesione të tilla. Ata theksuan domosdoshmërinë e ofrimit të trajnimeve për personelin e Inspektoratit Qendror të Punës për të rritur njohuritë e tyre në këtë fushë.

Më tej, IP-ja shprehu bashkëpunimin me institucione të tjera dhe gatishmërinë për të zgjeruar bashkëpunimin me autoritete shtesë ligjzbatuese.

---

<sup>1</sup> Për më tepër, shih Raportin analitik të FOL: “Dilemat praktiko-juridike të (pa)zbatueshmërisë së sinjalizimit në sektorin privat”.



## 5. Intervista me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përcakton se të gjitha institucionet, përfshirë edhe ato private, janë të detyruara të përgatisin raporte vjetore në lidhje me sinjalizimin dhe t'i dërgojnë ato në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Ndërkaq agjencia të dhënat në lidhje me raportimet, obligohet t'i publikoj në raportin vjetor të saj deri me 31 mars të vitit vijues.

Në raportet vjetore të agjencisë, figuron se gjatë tri viteve (2020, 2021 dhe 2022) vetëm 5 subjekte private kanë paraqitur raporte vjetore në APK<sup>2</sup>. Ky numër tregon se vetëm një përqindje e vogël e numrit të bizneseve, nga totali prej 721 biznese me mbi 50 punëtor sa operojnë aktualisht në territorin e Kosovës, kanë vepruar konform obligimeve ligjore. Kjo përveç se nga njëra anë mund të konsiderohet si mungesë e përgjegjësive së sektorit privat për përmbushjen e obligimeve ligjore për raportim, nga ana tjetër mund të shihet si mungesë e informacionit të ekzistimit të këtij obligimi ligjor nga ana e bizneseve.

Prandaj, për të përmbushur objektivat e këtij raporti, FOL zhvilloi edhe intervista me zyrtarë të këtij institucioni lidhur me planet e tyre për të rritur dhe forcuar masat për mbrojtjen e sinjalizuesve në të ardhmen. Kjo përfshin aspekte të tilla si trajnimi i stafit dhe përmirësimet e politikave që synojnë nxitjen e raportimit të sjelljeve të dyshimta si në institucionet publike ashtu edhe në ato private. Në këtë drejtim, përfaqësues nga ky institucion përmendën se për vitin 2024, agjencia planifikon të zhvillojë sesione trajnimi dhe tryeza të rrumbullakëta me zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin në institucionet publike. Kjo praktikë ka filluar vitin e kaluar, me pesë punëtor të zhvilluara tashmë. Qëllimi është rritja e kapaciteteve dhe sigurimi i njohurive praktike për zbatimin e kuadrit ligjor vendor për mbrojtjen e sinjalizuesve. Përveç kësaj, ata përmendën se agjencia do të eksplorojë rrugët për të mbështetur krijimin e kanaleve të sinjalizimit në sektorin privat. Kjo mbështetje mund të vijë nëpërmjet iniciativave të tyre ose në bashkëpunim me iniciativa nga sektori joqeveritar apo institucione që rregullojnë sektorë të ndryshëm të biznesit privat. Për më tepër, ata theksuan se agjencia synon të forcojë burimet e saj njerëzore për menaxhimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm, krahas rritjes së aftësive të saj teknike përmes pjesëmarrjes aktive në nismat rajonale. Duke filluar nga ky vit, agjencia planifikon të funksionalizojë një platformë raportimi elektronik (përfshirë opsionet e tekstit dhe zërit) dhe një adresë kontakti me email jashtë sistemit qeveritar. Ky veprim synon të sigurojë standardet më të larta të Komunikimit të pavarur. APK e konsideron përmbushjen e detyrimeve ligjore nga subjektet private si një prioritet të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Kjo për shkak se është demonstruar shpesh se veprimet dhe sjelljet korruptive nuk burojnë vetëm nga ana e kërkesës, por edhe nga ana e ofertës.

---

2 Sipas informacioneve të pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, në Kosovë aktualisht operojnë 121,829 biznese në total, nga të cilat 721 biznese janë me mbi 50 të punësuar

Sipas agjencisë, sa i përket raportimit në sektorin privat, duket se ka një vonesë në disa fusha:

- Caktim të zyrtarëve përgjegjëse për sinjalizim,
- Krijim të kushteve të nevojshme të punës për zyrtarët përgjegjës,
- Zhvillim të procedurave së brendshme për trajtimin e rasteve të sinjalizuara.

Sipas APK-së, fokusi primar është në krijimin e kanaleve të sinjalizimit në sektorin privat dhe sigurimin e trajnimit adekuat për zyrtarët përgjegjës. Më pas, përmes fushatave ndërgjegjësuere që synojnë promovimin e sinjalizimit, mund të inkurajohet raportimi i rasteve të dyshimta. Megjithatë, suksesi i fushatave të tilla varet nga krijimi i njëkohshëm i rrugëve të sigurta të raportimit. Kjo përfshin ndërtimin e besimit midis sinjalizuesve, sigurimin e konfidencialitetit dhe demonstrimin e një përkushtimi për mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja për shkak të zbulimeve të tyre.

## 6. Shënime përmbyllëse

Gjetjet e anketës zbulojnë mangësi thelbësore në ndërgjegjësimin, mirëkuptimin dhe pajtueshmërinë me ligjet për mbrojtjen e sinjalizuesve në mesin e bizneseve në Kosovë. Shumë të anketuar nuk ishin në dijeni të detyrimeve të tyre ligjore sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, duke theksuar një nevojë kritike për edukim dhe shpërndarje të informacionit. Ndryshimet në të kuptuarit e koncepteve kryesore të sinjalizimit tregojnë pasiguri të përhapur brenda komunitetit të biznesit, duke minuar potencialisht integritetin e mekanizmave të raportimit të brendshëm.

Për më tepër, ekzekutimi i detyrimeve ligjore, si caktimi i zyrtarëve të dedikuar për sinjalizimin dhe formulimi i udhëzimeve të brendshme për sinjalizimin, u rezultua se ishte zbatuar në mënyrë joadekuate në të gjithë bizneset e anketuara. Vështirësia në të kuptuarit dhe zbatimin e procedurave të raportimit nxjerr në pah nevojën e domosdoshme për trajnime të hollësishme dhe masa mbështetëse të përshtatura për të orientuar në mënyrë efektive vështirësitë e këtyre proceseve.

Megjithëse u pranua rëndësia e sinjalizimit në ruajtjen e standardeve etike dhe transparencës, një kontradiktë ndaj anomalive të raportimit mbizotëronte mes disa subjekteve afariste. Ky ngurrim i atribuohet shpesh mosbesimit mbizotërues ndaj organeve rregullatore, duke treguar një çështje më të thellë sistemike që pengon zbatimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

Efikasiteti i organeve mbikëqyrëse si Inspektorati i Punës dhe APK-ja është parësor në mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sigurimin e pajtueshmërisë me ligjin. Megjithatë, përpjekjet e tyre shpesh parandalohen nga mungesa e burimeve dhe kufizimet logjistike, të cilat zvogëlojnë ndikimin e roleve të tyre rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Në dritën e këtyre gjetjeve, rekomandohet fillimi i fushatave të synuara për rritjen e ndërgjegjësimit që synojnë të kapërcejnë hendekun e njohurive dhe të qartësojnë kërkesat ligjore që lidhen me sinjalizimin. Përpjekjet bashkëpunuese ndërmjet palëve të ndryshme të interesit, duke përfshirë subjektet qeveritare, shoqërinë civile dhe sektorin privat, janë thelbësore në kultivimin e një mjedisi të favorshëm për sinjalizimin. Rritja e kapaciteteve logjistike dhe burimeve njerëzore të institucioneve mbikëqyrëse është gjithashtu e rëndësishme, pasi do të mundësonte mekanizma më të fuqishëm të zbatimit dhe mbikëqyrjes, në fund të fundit duke ushqyer një kulturë transparence dhe llogaridhënieje brenda ekosistemit të biznesit.

# Shtojca I – Pyetësoni

Lëvizja FOL, me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës është duke punuar në një hulumtim lidhur me nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2019.

Për nevojat e këtij hulumtimi, Lëvizja FOL ka krijuar pyetësonin e mëposhtëm për subjektet e sektorit privat me mbi 50 të punësuar.

Kontributi juaj në plotësimin e këtij pyetësoni është tejet i çmuar dhe do të na ndihmonte në zhvillimin e hapave të mëtejme për të avokuar në zbatimin e sinjalizimit në sektorin privat.

.....

## 1. Çfarë lloj biznesi përfaqëson subjekti juaj?

- Bujqësi
- Ndërtimtari
- Sektori i marketeve
- Dyqane të tekstilit
- Media
- Shërbime të pastrimit
- Gastronomi/Hotelieri
- Sigurimi fizik i objekteve
- Shërbime të transportit
- Tjetër (specifikoni) \_\_\_\_\_

## 2. Në cilin rajon ndodhet biznesi juaj?

- Prishtinë
- Mitrovicë
- Pejë
- Prizren
- Ferizaj
- Gjilan
- Gjakovë
- Tjetër

### 3. Sa punonjës ka biznesi juaj. Sa prej tyre gra?

---

### 4. A ka biznesi/kompania juaj strukturë të brendshme të rregulluar (psh departamente, divizione, njesit, etj)?

- PO
- JO

### 5. A rregullohet struktura e brendshme me akt të brendshëm?

- PO
- JO

### 6. A keni zyre të dedikuar për burime njerëzore?

- PO
- JO

### 7. A jeni në dijeni për ekzistimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve?

- PO
- JO

**8. A e dini që sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve e keni obligim për të caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim në kompaninë tuaj?**

- PO
- JO

Nëse po, a e keni caktuar?

\_\_\_\_\_

**9. A keni pasur ndonjëherë ju ose dikush nga kolegët tuaj problem në kuptimin e termit "sinjalizim"?**

- PO
- JO

Nëse po, a mund të na përshkruani më në detaje këtë problematikë.

**10. A keni hartuar akt të brendshëm me të cilin rregullohet procedura e pranimit dhe trajtimit të rasteve të sinjalizimit?**

- PO
- JO

**11. Sa e keni të vështirë për të kuptuar hapat/procedurat e raportimit/sinjalizimit, të përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve?**

- Shumë të vështirë
- Pak të vështirë
- Aspak të vështirë

## 12. Sa të rëndësishëm e shihni sinjalizimin si mekanizëm për raportim në ambientin tuaj të punës?

- Shumë të rëndësishëm
- Pak të rëndësishëm
- Aspak të rëndësishëm

## 13. A keni pasur ndonjëherë nevojë për ndonjë trajnim të veçantë për të kuptuar ose për të përdorur sinjalizimin në ambientin tuaj të punës?

- PO
- JO

Nëse po, a keni zhvilluar ndonjë trajnim të tillë?

## 14. A ka paraqitur ndonjë nga kolegët e stafit tuaj ndonjë parregullsi të brendshme tek udhëheqësit e kompanisë?

- PO
- JO

## 15. A keni pasur ndonjëherë ndonjë rast ku kompania juaj ka paraqitur ndonjë parregullsi ose veprim të jashtëligjshëm para organeve kompetente (p.sh. shmangie të tatimit nga ndonjë kompani që keni pasur bashkëpunim; kallëzim të ndonjë vepre penale etj.)?

- PO (shtjello rastin) \_\_\_\_\_
- JO

**16. A mendoni se sinjalizimi në sektorin privat është i nevojshëm për rrethanat e Kosovës?**

- Është i nevojshëm
- Nuk është i nevojshëm

**17. A jeni të gatshëm të raportoni për ndonjë shkelje apo mosfunksionim që vëreni në aktivitetet e prokurimit publik ose në aktivitetet tjera që lidhen me institucionet publike (si p.sh. në shpërndarjen e subvencioneve, licencave, lejeve etj)?**

- PO
- JO

**18. A jeni inspektuar apo kontaktuar ndonjëherë nga Inspektorati i Punës në lidhje me caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim?**

- PO
- JO





